



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Nr. _____ prot.

Himarë, më ____ . ____ . 2025

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje karburant”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP) :

Karburant Diesel : 09134100-8

Benzinë:09132000-3

VLERA E FONDIT LIMIT: 8,333,333 (tete milion e treqinde e tridhjetë e tre mijë e treqinde e tridhjetë e tre) lekë , **pa TVSH.**

1. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të këtij loti.** Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për

miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2, të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar ku përcaktohet se: *“Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”*. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të zbatuar me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK.

Për sa i takon përcaktimit të vlerës së kërkuar prej jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se *“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”*. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve (2022,2023,2024) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit*.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit me nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në nenin 43, pika 4 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në pikën 5 të nenit 61 të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të këtij objekti**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose/dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
 - b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020

“Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimi, për realizimin e kontratës me sukses. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore etj, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

Në mënyrë që të mbulohet shërbimi i ofrimit të karburantit me efikasitet dhe efektivitet pranë autoriteteve kontraktore, operatori ekonomik duhet të paraqesë listën e karburanteve në pronësi ose me qera ku minimumi duhet të ketë stacion të tregtimit me pakicë të karburanteve:

- në bashkinë Himarë të ketë të paktën 1 (një) stacion të tregtimit me pakicë të karburanteve sipas Tabelës nr.1;

Operatori ekonomik duhet të paraqesë listën e detajuar të stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë që operojnë në bashkinë Himarë si dhe personin e kontakti sipas tabelës:

Tabela nr. 1 orientuese:

Nr	Bashkia Himarë	Vendodhja (adresa)	Person kontakti
1	‘Emri i pikës’		
2	*Etj.....		

*Etj- Nënkupton të gjitha stacionet të shitjes së karburanteve me pakicë të tjera të cilat operatori ekonomik i disponon (në pronësi ose me qera).

***Shenim 2.1:**

- Në pronësi dhe/ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e regjistrimit tregtar leshuar nga QKB;
- kontrate noteriale qeraje ose furnizimi;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM Nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës dhe nenprodukteve të saj”, të ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri nga ana e AK është bërë duke patur parasysh numrin e automjeteve të cilat duhet të furnizohen me karburant gjatë zbatimit të kontratës si dhe itineraret ditore që ato kryejnë në funksion të zbatimit të detyrave funksionale që ato kanë.

Në vendosjen e një numri minimal prej 1 stacioni tregtimi me pakicë të karburanteve në Bashkinë e Himarës është marrë parasysh madhësia e territorit të kësaj bashkie, si dhe numri i njesive që e kanë selinë dhe operojnë kryesisht në këtë bashki.

Për sa me lart, AK gjykon se kërkesa e mësipërme është plotësisht e argumentuar, në përputhje

dhe në përpjestim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit duke garantuar trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë dhe duke mos ngushtuar apo kufizuar konkurrencën.

Dokumentacioni për stacionet e tregtimit me pakice të karburanteve është kërkuar sipas parashikimit të pikes II “Procedura për dhënien e licencave për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëng-shëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga kon-sumatorët fundorë” të VKM Nr. 970, datë 02.12.2015 ”Për percaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës dhe nenprodukteve të saj”, i ndryshuar me ane të se cilit operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë liçencat profesionale si dhe dokumentacionin shoqërues, për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, në kushtet kur kemi të bëjmë me furnizim me kartë, sipas kërkesës së disa Autoriteteve.

2. Flete analiza të lëshuar nga ISHTI për ato zëra të cilat është i akredituar, brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e hapjes së ofertave sipas stadarteve në fuqi;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, me anë të së cilit kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë për rezultatet zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike brenda një afati të arsyeshëm.

3. Subjekti ofertues duhet të paraqesë edhe deklaratat si mëposhte:

- Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin pranë stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.
- Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin me karburant detyrimisht me pistoletë publike.
- Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër që të konvertojë të gjithë sasinë e litrave të ndodhura në kartën elektronike të personalizuar me targonë e mjetit në lëng me bot, deri në përfundimin e plotë të kontratës, sipas nevojave të autoritetit kontraktore. Karta elektronike duhet të jenë pa afat skadencë deri në përfundimin e plotë të kontratës.
- Për arsye të sasisë që duhet hedhur në magazinimet dhe në botet e ndërmarrjeve duhen edhe në tollona.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar dhe nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, me ane të se cilit operatori ekonomik vetedeklaron duke ofruar garanci për AK se furnizimi do të realizohet me karta elektronike sipas kërkesave të parashikuara më lart